

NJOFTIM PUNËSIMI

Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	<p>Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 “Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë. Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësojë <u>për dy vende pune</u>: Faturues/e pranë Sektorit të Leximit në Njësinë Operative Durrës nisur nga data më e afërt. Punëmarrësi i ri do të jetë përgjegjës për leximin e rregullt (mujo) të matëseve të klientëve që ndodhen në zonën që mbulon. Detyrat përfshijnë gjithashtu kryerjen e verifikimeve në terren në funksion të kërkesave për lidhje të reja dhe/ose lidhje të kontratave të reja me qëllim parandalimin e abuzimeve dhe lidhjeve të dyfishta.</p>
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	<ul style="list-style-type: none">• Gjatë leximit të matësit, kryen verifikime mbi gjendjen e matësit në lidhje me funksionimin e tij, vulosjen e tij, ndërhyrjeve të paligjshme dhe problematikave të tjera të ndryshme si rrjedhje, etj.• Rezultatet e verifikimeve sipas rastit dhe procedurave të miratuara i regjistron dhe raporton si anomali si dhe mban përgjegjësi për mos-raportimin apo raportimin qëllimisht të gabuar të anomalive.• Në fund të ditës dorëzon pranë Përgjegjës të Leximit, listat e plotësuara të leximit së bashku me regjistrin e anomalive (për zonat që nuk mbulohen me PDA).• Siguron faturat nga Përgjegjësi i Leximit dhe vijon me shpërndarjen e faturave tek klientët që ndodhen në zonën që mbulon.• Kryen verifikime të konsumit dhe matësit në terren sipas udhëzimeve të Zyrës së Faturimit në NjO dhe Drejtorisë së Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme.

	<ul style="list-style-type: none"> • Është i detyruar të vrojtojë, kontrollojë të gjithë përdoruesit e zonës së tij për të mos lejuar asnjë konsumator pa faturim si pasojë e mos-lidhjes së kontratës.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	<ul style="list-style-type: none"> • Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	<ul style="list-style-type: none"> • Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.
<ul style="list-style-type: none"> • Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 09.07.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar. 	